

Për:	Operatorë Ekonomik: PROGLOBAL SHPK me adresë në Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	02.02.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **01.02.2024**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **PROGLOBAL SHPK** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM I ZJARRFIKËSVE ME PAJISJE PROFESIONALE**, me Numër të prokurimit: **623-24-483-1-3-6**, Numër i brendshëm: **623-24-006-1-3-6**, nxjerr:

VENDIM

- I. **APROVOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **PROGLOBAL SHPK** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM I ZJARRFIKËSVE ME PAJISJE PROFESIONALE**, me Numër të prokurimit: **623-24-483-1-3-6**, Numër i brendshëm: **623-24-006-1-3-6**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **26.01.2024**, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave, pika II. *Kurdo qe miratimi i kërkesës ndërlidhet me **njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit**, Autoriteti Kontraktues do te beje publikimin e Njoftimit për korrigjim te gabimeve, duke përdorur formularin B54*
- III. **Vërejtje:** Komuna do të bëjë korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara sipas Ligjit të Prokurimit Publik **për Pretendimet ankimore qe janë pjesërisht të bazuar.**
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **PROGLOBAL SHPK** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM I ZJARRFIKËSVE ME PAJISJE PROFESIONALE**, me Numër të prokurimit: **623-24-483-1-3-6**, Numër i brendshëm: **623-24-006-1-3-6**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **29.01.2024**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **01.02.2024**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE E KËRKESËS

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Pozicioni. 1 - Çizme profesionale në raste vërshimesh

Me qellim që të respektohet LPP dhe të mos ketë diskriminim, ashtu që të trajtohen në mënyrë të barabartë të gjithë OE të interesuar për ofertim në këtë aktivitet të prokurimit dhe të ketë mundësi të barabartë pjesëmarrje për të gjithë OE të interesuar

Pozicioni 1. **DUHET** të specifikohet qfare lloji të qizmeve duhet ofertu:

Qizme të cekta deri nën xhunx, apo duhet të jenë qizme peshkatore deri nën krah

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj ankimor është i bazuar, dhe në sistemin e Prokurimit Elektronik – tek Dosja e Tenderit – Dokumenti Shtojca – Gjeni të bashkangjitur:

Përshkrimi i Çmimeve - Furnizimi i zjarrfikësve me pajisje profesionale - me korrigjime

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Pozicioni. 2 - Motosharrë për prerjen e drunjëve – është në tansi me specifika të prodhuesit të caktuar

Të behen ndryshime në Specifikimet Teknike – të jenë neutrale

Pozicioni 2. **DUHET** të jete me tolerance të të dhënave teknike: fuqi 2.4kW/3.2HP, peshe

3/3

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj ankimor është i bazuar, dhe ne sistemin e Prokurimit Elektronik – tek Dosja e Tenderit – Dokumenti Shtojca – Gjeni te bashkangjitur:

Përshkrimi i Çmimeve - Furnizimi i zjarrfikësve me pajisje profesionale - me korrigjime

PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

Pozicioni 3 - Pompa shpinore për fikjen e zjarreve malore dhe fushore - është në tansi me specifika të prodhuesit të caktuar

Te behen ndryshime në Specifikimet Teknike – të jenë neutrale

Pozicioni 3. **DUHET** të mundësohet: pompe shpinore nga materialet pelhure poliesteri të veshur me PVC me trajtim mbrojtës kundër djegies, kapacitet 19L.

Temperatura testuese -40°C deri 70°C, sipas standardit EN 1876-1.

Distanca e vrshkullit të plotë deri 12 m,

Distanca e vrshkullit shpërndarës deri 3 m,

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

Ju sqarojmë se ky pretendim i juaj ankimor është i pabazuar, pasi që

Autoriteti Kontraktues gjatë përcaktimit të Specifikave Teknike është kujdesur që në maximum ti respektoj parimet thelbësore të përcaktuara me LPP siç janë, **Konkurrenca, Trajtimi i barabartë dhe jo diskriminim**. Gjithashtu Autoriteti Kontraktues është kujdesur që të vendos vetëm Specifikat Teknike në pajtueshmëri me objektin e kontratës.

Specifikat teknike të përcaktuara nga AK, kanë një përshkrim neutral ligjor, dhe nuk ka karakterin diskriminues apo kufizues për Operator Ekonomik të interesuar për këtë aktivitet të prokurimit.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 5 (pesë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>